

VENDIM
Nr. 181, datë 7.8.2025

MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “FIER THERMOELECTRIC” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1763/8 prot., datë 1.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Fier Thermoelectric’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1763 prot., datë 26.5.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentrali, me kapacitet të instaluar 170 mw, me vendndodhje në Roskovec, Fier.

Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 9.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Fier Thermoelectric” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.6.2025 dhe 11.6.2025). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1763/4 prot., datë 12.6.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të munguar.

- Me shkresën nr. 1763/3 prot., datë 12.6.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar të bëjë me dije nëse ka një qëndrim tjetër, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

Paraqitja e komenteve/objeksioneve

- Gjatë afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, në ERE janë depozituar komente/objeksione në lidhje me këtë projekt, përkatësisht nga shoqata “Zharrëza”, protokolluar me nr. 2018 prot., datë 7.7.2025, dhe nga z. Lavdosh Ferruni (Shoqata e Bujqësisë Organike dhe Mjedisit), protokolluar me nr. 2018/2 prot., datë 7.7.2025.

- Duke qenë se komentet apo objeksionet e paraqitura në lidhje me këtë projekt, lidheshin me dokumente të lëshuara nga organe të tjera kompetente, u vlerësua zhvillimi i një seance dëgjimore. Për këtë qëllim, me shkresën e ERE-s nr. 2018/5 prot., datë 18.7.2025 dhe *email*-in e së njëjtës ditë, u ftuan të merrnin pjesë z. Ferruni, përfaqësues të shoqatës “Zharrëza”, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Drejtorisë Rajonale të Mjedisit (ARM) Fier, të “OST” sh.a. dhe vetë shoqërisë “Fier Thermoelectric” sh.a.

- Në seancën e zhvilluar në mjediset e ERE-s, më datë 29.7.2025, pasi përfaqësuesit e palëve që kishin paraqitur në ERE komentet/objeksionet parashtruan pretendimet e tyre, këtyre pretendimeve iu dhanë përgjigjet përkatëse nga vetë shoqëria “Fier Thermoelectric” sh.a., nga përfaqësuesit e

organeve kompetente sipas fushave të përgjegjësisë për çështjet e ngritura, si dhe nga përfaqësuesit e ERE-s, në lidhje me procedurën dhe dokumentacionin e licencimit, duke sqaruar se, në referencë të përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka kompetencë vetëm për dhënien e të drejtës së operimit të centralit prodhues të energjisë elektrike, pasi subjekti aplikues të ketë paraqitur dokumentet për marrjen e të gjitha lejeve ose autorizimeve përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

- Z. Ferruni bëri me dije gjatë seancës se disponon prova dokumentare në mbështetje të pretendimeve të tij, një pjesë të të cilave i ka depozituar pranë protokollit të ERE-s pas seancës dëgjimore, të protokolluara me nr. 2018/6 prot., datë 29.7.2025, ndërsa për pjesën tjetër u angazhua t’i paraqesë, në formën e kërkuar nga ligji, brenda datës 1.8.2025.

- Po ashtu, shoqëria, pas sqarimeve të dhëna në seancë se çështjet e ngritura në kuadër të komenteve apo objeksioneve të paraqitura në ERE bëjnë pjesë në proceset gjyqësore mes palëve, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2018/7 prot., datë 31.7.2025, ka paraqitur sqarimet dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me këto procese gjyqësore.

- Në vijim është paraqitur dhe një kërkesë për informacion, protokolluar në ERE me nr. 2018/1 prot., datë 7.7.2025, së cilës i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 2018/3 prot., datë 17.7.2025.

Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Me shkresën nr. 1763/5 prot., datë 2.7.2025, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin plotësues nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion të paplotësuar, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 1763/6 prot., datë 18.7.2025.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1763/7 prot., datë 29.7.2025, shoqëria ka referuar se është e angazhuar për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e aplikimit, por në lidhje me marrjen e autorizimit dhe lejes përkatëse për përdorimin e burimit ujqor në zbatim të VKM-së nr. 319, datë 11.6.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, afati ligjor shkon deri në 180 ditë për një leje/autorizim. Në këto rrethana, shoqëria ka paraqitur kërkesën e saj për të shtyrë afatin e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, duke marrë parasysh afatet ligjore për sigurimin e lejeve pranë AMBU-së, periodhë brenda të cilës shoqëria do të plotësojë dhe dokumentacionin e munguar të aplikimit.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Në përputhje me nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, kur organi publik që zhvillon procedurën përballat me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për përfundimin e saj dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë ose organ tjetër (çështje paraprake), ai pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palët në lidhje me këtë.

- Gjithashtu në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, pezullimin e vendimmarrjes pas fillimit të procedurës.

- Referuar kërkesës së shoqërisë dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, sikurse më sipër cituar, për shkak dhe se marrja e autorizimeve/lejeve për përdorimin e burimit ujqor përkatës është dokument thelbësor për këtë procedurë, vlerësohet të pezullohet procedura për licencimin e shoqërisë “Fier Thermoelectric” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, nga termocentrali, me kapacitet të instaluar 170 mw, me vendndodhje në Roskovec, Fier, deri në depozitimin nga shoqëria të autorizimeve/lejeve të përdorimit të burimit ujqor të nevojshëm për operimin e termocentralit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 319, datë 11.6.2025. Ky vendim është objekt rishikimi me depozitimin e këtij dokumentacioni nga ana e shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Fier Thermoelectric” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentrali me kapacitet të instaluar 170 mw, me vendndodhje në Roskovec, Fier.

2. Ky vendim është objekt rishikimi me depozitim nga shoqëria të autorizimeve/lejeve të përdorimit të burimit ujor të nevojshme për operimin e termocentralit.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Fier Thermoelectric” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti